


Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Janar, 2019

Tiranë, më 08 Shkurt 2019: Indeksi i Çmimeve të Konsumit në muajin Janar 2019, arriti 107,6 kundrejt muajit Janar 2015.

Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Janar 2019 është 1,9 %. Një vit më parë ky ndryshim ishte 1,7 %. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Janar 2019, krahasuar me Dhjetor 2018, është 1,6 %.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të çmimeve të konsumit (%)




Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit.

Rritja vjetore e çmimeve në muajin Janar është ndikuar kryesisht nga grupet “Ushqime dhe pije joalkoolike” me +1,62 pikë përqindje, pasuar nga “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me +0,17 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Pije alkoolike dhe duhan” kanë kontribuar me +0,06 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Argëtim dhe kulturë” kanë kontribuar me +0,05 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Hotele, kafene dhe restorante” kanë kontribuar me +0,04 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Shërbimi arsimor” kanë kontribuar me +0,02 pikë përqindje. Çmimet e grupeve “Komunikimi” dhe “Mallra dhe shërbime të ndryshme” kanë kontribuar me +0,01 pikë përqindje secili. Çmimet e grupit “Veshje dhe këpucë” kanë kontribuar me -0,04 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Shëndeti” kanë kontribuar me -0,02 pikë përqindje.

Çmimet e grupit “Transporti” kanë kontribuar me -0,01 pikë përqindje.

Fig.2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor



Ndryshimet vjetore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Janar 2018, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 4,3 %, pasuar nga grupet “Argëtim dhe kulturë” dhe “Pije alkoolike dhe duhan” me 1,8 % secila, “Hotele, kafene dhe restorante” me 1,1 %, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 0,8 %, “Shërbimi arsimor” me 0,7 %, “Komunikimi” me 0,4%, etj. Nga ana tjetër çmimet e grupit “Veshje dhe këpucë” u ulën me 0,8 % pasuar nga grupi “Shëndeti” me 0,6 %. Brenda grupit të ushqimeve çmimet e nëngrupit “zarzavate përfshirë patatet” u rritën me 36,3 %, pasuar nga nëngrupet “qumësht, djathë dhe vezë” me 1,3 %, “peshk” me 1,0 %, etj. Nga ana tjetër çmimet e nëngrupit “fruta” u ulën me 8,2 %, pasuar nga “sheqer, recel, mjaltë, çokollata dhe ëmbëlsira” me 2,6 %, “bukë dhe drithra” me 1,5 %, etj.

Ndryshimet mujore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Dhjetor 2018, çmimet e grupit “Ushqime dhe pije joalkoolike” u rritën me 4,6 %, pasuar nga grupet “Pije alkoolike dhe duhan” me 0,3 %, “Veshje dhe këpucë” me 0,2 %, etj. Ndërsa, çmimet e grupit “Transporti” u ulën me 1,4 %, pasuar nga grupet “Argëtim dhe kulturë” me 0,6 %, “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me 0,1 %.

Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Janar 2015=100

Kodi	Grupet	Peshat	01-18	02-18	03-18	04-18	05-18	06-18	07-18	08-18	09-18	10-18	11-18	12-18	01-19
	Gjithsej	100	105,6	106,4	106,7	106,2	104,9	104,9	104,6	105,0	105,2	105,0	104,8	105,9	107,6
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	37,0	110,8	113,1	114,1	112,5	109,2	108,8	108,2	109,1	109,5	108,4	107,8	110,6	115,7
2	Pije alkoolike dhe duhan	3,5	102,9	103,0	103,6	103,6	103,3	103,4	103,4	103,4	103,3	103,4	103,7	104,4	104,7
3	Veshje dhe këpucë	3,6	101,0	100,4	99,5	99,3	98,5	99,0	98,5	98,4	98,9	99,6	99,8	99,9	100,2
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	21,5	104,4	104,4	104,0	104,1	104,1	104,3	104,2	104,3	104,4	105,0	105,1	105,3	105,3
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	5,6	100,1	100,3	100,2	99,9	99,9	99,7	99,2	99,3	99,5	99,6	99,7	100,2	100,1
6	Shëndeti	3,2	100,3	100,3	100,3	100,3	100,4	99,9	99,6	99,6	99,6	99,6	99,4	99,8	99,7
7	Transporti	6,9	101,2	101,1	101,2	101,4	101,8	102,4	103,0	103,3	103,5	104,3	103,8	102,6	101,2
8	Komunikimi	2,8	100,8	101,2	101,3	101,1	101,1	101,1	101,1	101,1	101,1	101,1	101,2	101,3	101,3
9	Argëtim dhe kulturë	2,7	102,4	102,8	103,9	105,6	105,8	105,8	105,2	105,7	107,8	106,7	104,9	105,0	104,3
10	Shërbimi arsimor	3,3	101,3	101,3	101,3	101,3	101,3	101,3	101,3	101,3	101,4	102,0	102,1	102,1	102,1
11	Hotele, kafene dhe restorante	4,1	100,7	100,8	100,9	101,0	101,0	101,0	101,2	101,2	101,1	101,2	101,2	101,8	101,8
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	5,7	103,6	103,6	103,7	103,8	103,7	103,7	103,6	103,6	103,6	103,5	103,5	103,6	103,8

Tab. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	01-18/01-17	02-18/02-17	03-18/03-17	04-18/04-17	05-18/05-17	06-18/06-17	07-18/07-17	08-18/08-17	09-18/09-17	10-18/10-17	11-18/11-17	12-18/12-17	01-19/01-18
	Gjithsej	1,7	2,1	2,0	2,1	2,1	2,4	2,3	2,2	2,1	1,9	1,8	1,8	1,9
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	2,2	2,7	3,1	3,1	2,8	3,2	3,0	2,8	2,6	1,8	2,0	2,8	4,3
2	Pije alkoolike dhe duhan	1,5	1,6	1,9	1,7	1,6	1,6	1,7	1,8	1,7	1,8	1,9	2,5	1,8
3	Veshje dhe këpucë	1,1	2,9	1,8	3,4	2,2	3,3	2,3	2,4	0,6	-0,3	-0,4	-1,6	-0,8
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	3,3	3,1	2,2	2,5	2,7	2,9	2,8	2,8	2,8	3,4	3,1	2,2	0,8
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	-0,2	0,2	0,2	0,0	0,0	-0,1	-0,3	-0,2	0,0	0,1	0,0	0,0	0,1
6	Shëndeti	0,1	0,1	0,0	0,2	0,2	-0,2	-0,5	-0,4	-0,4	-0,4	-1,0	-0,5	-0,6
7	Transporti	1,8	2,3	1,3	1,0	2,1	3,1	3,2	3,0	3,2	4,3	2,5	1,4	0,0
8	Komunikimi	0,6	1,0	1,0	0,6	0,6	0,6	0,6	0,6	0,7	0,7	0,6	0,5	0,4
9	Argëtim dhe kulturë	-0,8	-0,2	0,5	0,8	3,5	4,2	4,6	5,3	5,2	3,2	3,0	2,7	1,8
10	Shërbimi arsimor	0,6	0,6	0,6	0,6	0,6	0,6	0,6	0,6	0,5	0,8	0,8	0,7	0,7
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,7	0,7	0,7	0,9	0,9	0,9	1,1	1,1	1,0	1,0	1,0	1,2	1,1
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	0,3	0,4	0,2	0,5	0,3	0,3	0,2	0,2	0,1	0,1	0,1	0,1	0,2

Tab. 3 Ndryshimet mujore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	01-18	02-18	03-18	04-18	05-18	06-18	07-18	08-18	09-18	10-18	11-18	12-18	01-19
	Gjithsej	1,5	0,8	0,3	-0,5	-1,2	-0,1	-0,3	0,4	0,2	-0,2	-0,2	1,1	1,6
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	3,1	2,0	0,9	-1,4	-3,0	-0,3	-0,5	0,8	0,3	-1,0	-0,6	2,6	4,6
2	Pije alkoolike dhe duhan	1,1	0,1	0,6	0,0	-0,3	0,1	0,0	0,0	-0,1	0,0	0,3	0,7	0,3
3	Veshje dhe këpucë	-0,5	-0,6	-0,9	-0,2	-0,8	0,5	-0,5	-0,2	0,6	0,7	0,2	0,1	0,2
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	1,3	0,0	-0,4	0,1	0,0	0,1	0,0	0,0	0,1	0,6	0,1	0,1	0,0
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	-0,1	0,2	-0,1	-0,2	-0,1	-0,1	-0,6	0,2	0,1	0,2	0,0	0,5	-0,1
6	Shëndeti	0,0	0,0	0,0	0,0	0,1	-0,5	-0,3	0,0	0,0	0,0	-0,2	0,4	0,0
7	Transporti	0,0	-0,1	0,1	0,2	0,4	0,6	0,5	0,3	0,2	0,8	-0,5	-1,2	-1,4
8	Komunikimi	0,0	0,4	0,0	-0,2	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,1	0,1	0,0
9	Argëtim dhe kulturë	0,2	0,4	1,0	1,7	0,2	0,0	-0,5	0,4	2,0	-1,0	-1,7	0,1	-0,6
10	Shërbimi arsimor	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,1	0,6	0,0	0,0	0,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,2	0,1	0,0	0,1	0,0	0,0	0,1	0,1	-0,1	0,0	0,0	0,6	0,0
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	0,0	0,0	0,1	0,2	-0,2	0,0	-0,1	0,0	-0,1	0,0	0,0	0,1	0,1

Metodologjia

- Ndryshime metodologjike

Në muajin Janar të çdo viti Indeksi i Çmimeve të Konsumit shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjise ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistojnë në:

- Përditësimin e peshave: Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë ndryshuar duke u bazuar në shpenzimet mesatare të Anketës së Buxhetit të Familjeve 2017.
- Përditësimin e listës së mallrave dhe shërbimeve: Shporta përbëhet nga 331 produkte dhe shërbime.
- Përditësimin e listës së njësive tregtare ku mbliidhen çmimet.

Përkufizime

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri. Indeksi mat ndryshimet relative të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga familjet për konsum vetjak dhe llogaritet duke përdorur strukturën e konsumit final të familjeve shqiptare. Burimi kryesor i informacionit për shpenzimet është Anketa e Buxhetit të Familjeve.

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj.

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm. Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.